


"AURUM CONSTRUCTION" Sh.p.k
TIRANE

RAPORT TEKNIK TEKNIKE
Shfrytezim i mineralit te gurit gelqeror,
Zona Nr. 799/3
"ZALL HERR", TIRANE



Vendndodhje :Zona minerare nr.799/3 ,objekti "Zall Herr",Tirane

INVESTITOR: SHOQËRIA "AURUM CONSTRUCTION" sh.p.k
PROJEKTUES :« H&M MINING»PROJEKTE DHE KONSULENCE

Ekspert Mjedisi Ing. Miniere Adhurim Çaushi

Ekspert Mjedisi Denis Harasani



Tirane, 2021

" H&M MINING" PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku "Vasil Shanto", Rruga, "Preng Bib Doda" Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

1. PERSHKRIMI I PROJEKTTIT

- a. Qellimi i projektit te propozuar
- b. Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes se tokes se kerkuar,te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit GAUSS KRUGER, fotografi dhe te dhena per perdorimin eksistues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve
- c. Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administron territorin ku propozohet projekti
- ç. Skicat dhe planimetrite e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit
- d. Pershkrim i proceseve ndertimore dhe teknologjike te shfrytezimit te gurit gelqerore me kariere, perfshire kapacitetin prodhues, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit.
- e. Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja
- f. Programi per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatjen e planifikuar te funksionimit te projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe sipas rastit edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te siperfaqes pas mbarimit te funksionimit te projektit
- g. Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit
- h. Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje, energji)
- i. Informacion per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/prane zones te projektit
- j. Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate persai takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do perdoret
- k. Perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshme , energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre
- l. Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit , si ndertim i kampeve apo rezidencave etj.
- m. Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin/licensimin e projektit
- k. kopje te lejeve, autorizimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar , ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin/autorizimin/licencimin e projektit.

"H&M MINING" PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku "Vasil Shanto", Rruga, "Preng Bib Doda" Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

HYRJE

Shoqëria " AURUM CONSTRUCTION" shpk është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në fushën e aktivitetit për shfrytëzim përpunim në qiell të hapur (kariera) dhe tregtim të lendeve minerare të grupit të IV etj.

Shoqëria "AURUM CONSTRUCTIONj" sh.p.k, ka objekt të aktivitetit të saj kryerjen e punimeve të ndryshme ka marrë plese në konkurimin e zhvilluar me datë 14.10.2020 për fitimin e së drejtës për pajisje me lje minerre shfrytëzimi në objektin e gurit gelqeror , zona minerare konkurrese nr 799 Zall Her Tirane, dhe me shkresë të Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë nr. 6385 Prot, datë 13.10.2020, është shpallur fitues dhe është njoftuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë për të aplikuar për marrjen e lejes minerare të shfrytëzimit në zonën minerare nr 799/3, Zall Herr, Tirane

Në Shqipëri fillimet e legjislativitetit mjedisor shfaqen në vitin 1993 , vit në të cilin u hartua plani i parë i veprimit në fushën mjedisore, që përben dokumentin e parë zyrtar shqiptar mbi politikën mjedisore në vend. Ky plan veprimi kombëtar parashikonte se qeveria duhet të krijojë kuadrin ligjor , ekonomik dhe institucional për zgjidhjen e çështjeve mjedisore. Periudhën nga ky vit deri në miratimin e Kushtetutës në vitin 1998 mund ta konsiderojmë si etapën e parë të zhvillimit të së drejtës shqiptare të mjedisit. Mbas vitit 1998 e në vijim është periudha e dytë e zhvillimit të së drejtës shqiptare të mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e përafërimit me legjislativitetin e Bashkimit Europian për mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar është në përsosje dhe pasurim të vazhdueshëm dhe zhvillimi i tij nuk i është len rasteies, por ka si model dhe drejtues legjislativitetin europian të mjedisit. Duke qenë se kushtetutat ravigjezojnë drejtëtimet e rregullimeve të ardhshme dhe me të hollësishme që realizohen fillimisht me ligje dhe me pas me akte nënligjore edhe në rastin e vendit tonë Kushtetuta përben një fillësë dhe bazë të rëndësishme lidhur me rolin që ka mjedisi për shoqërinë dhe shtetin tonë. Nisur nga përmbajtja e nënëve të Kushtetutës lidhur me fushën mjedisore mund të pohojmë se fryma e Kushtetutës sone është në përputhje me atë të shumë kushtetutave të vendeve të tjera demokratike që u kushtojnë rëndësi të një niveli me të lartë disa përimeve mjedisore, duke i ngritur ato në nivelin e ligjit themelor të shtetit, sic janë e drejta për informimin e qytetarëve dhe angazhimi e përgjegjësia për një mjedis të përshatshëm për të jetuar jo vetëm brezat e sotëm por edhe ata në të ardhmen.

"H&M MINING" PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku "Vasil Shanto", Rruga, "Preng Bib Doda" Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

Legjislacioni mjedisor

- VKM nr.686 date 29.7.2015 « **Per miratimin e rregullave , te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e Deklarates Mjedisore »**
- Ligj nr 12/2015 **per disa ndryshime ne ligjin nr. 10440 date 07.07.2011 « Per vleresimin e ndikimit ne mjedis »**
- VKM nr. 435 date 12.09.2015 « **Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise »**
- VKM nr. 575 date 24.06.2015 **“Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”**
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « **Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subject te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKLja.**
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 **“Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”**
- Vendim nr. 13 date 4.1.2013 « **Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis »**
- VKM nr. 765 date 07.11.2012 **“Per miratimin e rregullave per grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave te perdorura”**
- Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 **“ Per Mbrojtjen e Mjedisit”**
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 **“Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”**
- Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « **Per Lejet e Mjedisit »**
- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « **Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »**
- Ligj Nr 10304, datë 15.7.2010 **“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.**
- Ligj nr. 10266 date 15.04.2010 **“Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja” per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”**
- Udhezimin nr.12 date 15.06.2010 **per disa ndryshime ne Udhezim nr. 6527 date 24.12.2004 “Mbi Vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe menytrat e kontrollit te tyre”**
- Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 **“Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”**
- Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 **“Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”**

“H&M MINING” PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku “Vasil Shanto”, Rruga, “Preng Bib Doda” Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

- Udhëzim Nr 3, datë 17.05.2006 ***“Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”***
- VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 ***“Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.***
- Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 ***“Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.***
- Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 ***“Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”. Të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.***
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 ***“Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”***
- Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 ***“Për zonat e mbrojtura”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.***
- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 ***« Per largimin publik te mbeturinave »***

a. qellimi i projektit te propozuar

Qellimi i projektit te propozuar nga shoqëria "AURUM CONSTRUCTIONJ" sh.p.k është shfrytëzimi i gurit gelqeroreme kariere me punime siperfaqesore , objekti zona minerare konkurruese nr.799/3, objekti Zall Herr rrethi Tirane, per nxjerrjen e mineralit te gurit gelqeror qe sherben si lende e pare ne industrine e ndertimit.

Kjo zone është e ofron kushte lehtësuese për shfrytëzimin e gurit gelqerore me kariere me punime siperfaqesore sepse është një zone large qendrave te banuara, kun prek vepra te veçanta dhe nuk bene pjeswe ne ndonje zone te mbrojtur rruge per ne objekt jan pothuaj te hapura dhe me pake punime mund te fillohet nga aktivitetit. Nga pikpamja gjeografike terreni ku ndodhet objekti per shfrytëzim « guri gelqeror » është terren kodrinor.

Shoqëria “AURUM CONSTRUCTION” sh.p.k, ka objekt te aktivitetit te saj kryerjen e punimeve te ndryshme ka marre pjese ne konkurimin e zhvilluar me date 05.08.2020 per fitimin e se drejtes per pajisje me lje minerre shfrytëzimi ne objektin e gurit gelqeror , zona minerare konkurruese nr 799 "Zall Herr" Tirane, dhe me shkrese te Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise nr. 6385/2 Prot, date 13.10.2020, është shpallur fitues dhe është njoftuar nga Ministria e Inffastruktures dhe Energjise te per te aplikuar per marjen e lejes minerare te shfrytëzimit ne zonen minerare nr 799/3 Zall Her, Tirane

Persa i perket referencave per harta kadastrale pyjore keto do ti paraqiten Ministrise se Mjedisit pasi shoqëria pajiset me leje mjedisore dhe fillojne procedurat per heqjen nga fondi pyjor ne baze te vendimit nr.1374 date 10.10.2008 Per percaktimin e rregullave dhe te

“H&M MINING” PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku “Vasil Shanto”, Rruga, “Preng Bib Doda” Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

procedurave qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e detinacionit te fondit kullosor, vendim nr.435 date 8.6.2016 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.1374 date 10.10.2008 te Keshillit te Ministrave "Per percaktimin e rregullave dhe te procedurave, qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit Kullosor", Vendim nr.1353 date 10.10.2008 Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses, mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit teknik si dhe te kritereve te procedurave te zvogelimit te sipërfaqes e te vellimit te fondit pyjor, Vendim nr. 434 date 8.6.2016 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.1353 date 10.10.2008 te keshillit te ministrave Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses , mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit teknik si dhe te kritereve e te procedurave te zvogelimit te sipërfaqes e te vellimit te fondit pyjor"

b. Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harte topografike kulijte e sipërfaqes se tokes se kerkuar,te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit GAUSS KRUGER, fotografi dhe te dhena per perdorimin eksiztues te sipërfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekt gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve

Vendndodhja e objektit

Gjeografikisht, objekti i kërkuar në luginën e lumit të Zall Herrit në të majtë të rrugës që lidh Komunën e Zall Herrit me ujëmbledhësin e Bovillës.reth 450 metra më në veri të rrugës dhe linjës së tubacionit të ujit.

Rilevimi te zonës që kërkohet është përgjithësisht kodrinor dhe vendoset poshtë rrëzimit të malit të Gamlitit, ne jugperendim te vndit te quajtur Faqja e Buze Herrit, ne veri te fshatit herra j rretj 1 km ne veri te ketij fshati, ne veri perendim kufizohet nga fshati Mukje, ne perendim nga lagje Radhesh (Hidaj), përgjithësisht i çveshur dhe pa ndonjë bimësi të zhvilluar, largë objekteve të banimit dhe rrugës auto.Brënda zonës nuk ka objekte banimi, apo të rëndësishme të veçant.

Nga pikpamja topografike vendoset në sipërfaqen me koordinata si në tabelën më poshtë:

Koordinatat e zonës nr. 799/3, Zall Herr

Pika	X	Y
1	4590550	4402900
2	4590729	4403323
3	4590665	4403441
4	4590590	4403495

"H&M MINING" PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku "Vasil Shanto", Rruga, "Preng Bib Doda" Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

5	4590372	4403265
6	4590332	4402970

Sipërfaqja e zoës në planin horizontal është 0.141 km²

Projekti i hartuar ka për qëllim studimin e mundësise së shfrytëzimit të gelqeroreve në zonën konkurruese NR 799/3 të objektit "Zall Herr" nga subjekti., që ka konkuruar për të drejtën e aplikimit për leje minerare shfrytëzimi për zonën konkurruese Nr 799, të miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2019 dhe me shkresën e MEI-t me nr. 6385 Prot, datë 13.10.2020, ka marrë njoftimin fituesit të konkurimit të kryer për të drejtën e aplikimit.

E drejta e konkurimit dhe e aplikimit subjektit i është dhënë në përputhje me ligjin Nr 10304, datë 15/07/2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM Nr 320, datë 21.04.2011 "Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurimit dhe afatëve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese.

Për hartimin e studimit tekniko-ekonomik dhe projektit të shfrytëzimit të këtij objekti janë marrë në konsideratë :

- ✚ Pozicioni gjeografik dhe mardhëniet e objektit me qendrat e banuara
- ✚ Topografia dhe klima e zonës në të cilën ndodhet objekti i marrë në konsideratë
- ✚ Hidrologjia dhe hidrografia e zonës në të cilën kufizohet objekti i shfrytëzimit .
- ✚ Hidrogeologjia e zonës në të cilën kufizohet objekti i shfrytëzimit, mundësia e daljes së burimeve të ndryshme brenda zonës së shfrytëzimit dhe parandlimi i pasojave të tyre në procesin e shfrytëzimit .
- ✚ Klima rreshjet dhe intensiteti i tyre si një faktor i rëndësishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar
- ✚ Gjendja e infrastruktures së rajonit në përgjithësi dhe të zonës së objektit , mundësitë e përmirësimit të saj, ndërtime dhe instalime të tjera të domosdoshme për shfrytëzimin e objektit nga pikpamja minerare.
- ✚ Materiali gjeologjik bazë lidhur me ndertimin gjeologjik të rajonit dhe objektit, sasinë dhe cilësinë e rezervave gjeologjike dhe të shfrytëzueshme brenda kufijve të përcaktuar të shfrytëzimit
- ✚ Matjet dhe dokumentimet e ndryshme të kryera në terren lidhur me vetitë gjeomekanike, karakteristikat fiziko-mekanike dhe parametrat gjeoteknike të formacione, që ndërtojnë vendburimin, të cilat mund të kufizojnë në mënyrë të natyrishtme përmasat e blloqeve shkembore në sipërfaqe dhe thellesi të objektit dhe të detyrojnë përdorimin e mënyrave të pershateshme të rrezimit të gurit gelqeror

"H&M MINING" PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R


Blloku "Vasil Shanto", Rruga, "Preng Bib Doda" Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

- ✚ Kërkesa të ndryshme për makineri, pajisje dhe investime të tjera për përgatitjen dhe shfrytëzimin e objektit.
- ✚ Respektimi i Rregullores së Teknikës së Sigurimit në Karierra dhe mbrojtja e zonave të banuar për rreth si dhe mjedisit .
- ✚ Llojet e produkteve të prodhuara dhe tregu i shitjes së tyre

"AURUM CONSTRUCTION" SH.P.K



"H&M MINING" PROJEKTE E KONSULENCE


NUIS: L62412026R

Blloku "Vasil Shanto", Rruga, "Preng Bib Doda" Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

"AURUM CONSTRUCTION" SH.P.K



"H&M MINING" PROJEKTE E KONSULENCE
NUIS: L62412026R
Blloku "Vasil Shanto", Rruga, "Preng Bib Doda" Pallati 1, Tiranë
Tel. 00355672051830
E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

Kjo zone eshte e papyllezuar, pa objekte banimi e industriale dhe nuk gezon ndonje status te vecante. Objekti eshte i lidhur me rrugen ekzistuese nacionale. Zona nuk ka ndonje perdorim te vecante ,eshte shfrytezuar nga shoqeria per nxjerrjen e gurit gelqeror. Ne perfundim te aktivitetit kjo zone do te rehabilitohet dhe do ti kthehet funksionit te meparshem te saj dhe perdorimit nga banoret e zones per kullote.

c. Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administroin territorin ku propozohet projekti

Rajoni ne te cilin perfshihet edhe zona e studimit, ben pjese ne zonat e jashteme te Albanideve, ne zonen tektonike te Krujes, ne n / zonen Dajti, ne strukturen e Makareshit. Zona Kruja shtrihet ne trajten e nje brezi qe nga bregdeti i Adriatikut ne veriperendim te Shengjinit, e deri prane Leskovikut ne jug. Ne lindje kufizohet me zonen tektonike Krasta - Cukali me te cilen ka kontakt kryesisht tektonik, meqense kjo e fundit ka mbihipur mbi te, ndersa ne perendim kufizohet me zonen Jonike. Ka shtrirje te pergjithshme veriperendim – juglindje me azimut 330⁰, ndersa strukturat me veriore te saj shmangen pak me ne perendim me azimuth 300⁰. Kufiri i zones Kruja me zonen Krasta – Cukali eshte i qarte gjate gjithë shtrirjes se saj.

Gjeografikisht, objekti i kërkuar në luginën e lumit të Tiranës, në krahun e djathtë të rrjedhës së mesme të tij në veriperendim rreth 1.5 km kufizohet nga fshati Mukje në juglindje të zones shtrihet fshati Haraj rreth 350 m dhe Herraj mbi 1 km në lindje ngrihet mali i Gamlitit me lartësi 1259 m mbi nivelin e detit me në jugperndim shtrihet fshati Kallmet dhe Pinari

Objekti vendoset për aafersisht në kufirin ndërmjet rrethëve të Tiranës dhe Krujës

Te dy qytete kanë histori të vjetër dhe e re si ish kryeqytete të vendit në periudhën e Skenderbeut dhe Tiranës kryeqytet modern i viteve të pas shpalljes së Pavarësisë të dy të lidhura ngushtë me e shkuarën dhe të tashmen e historisë së Shqipërisë. Te dy këto qytete karakterizohen nga ndryshime të forta në kohën e tanishme, ka zhvillim të madh në sektorët e industrisë dhe të turizmit

Nga pikëpamja administrative, i përketë njesisë vendore Zall Herr dhe i përket rrethit të Tiranës. Qendrat e tjera të banuara janë qyteti i Tiranës në jug të zones, fshatrat Kallmet, Pinar, Herraj, Zall Herr e Tufinë dhe me në perndim shtrihen lagjet periferike të Kamzës

Objekti i kërkuar nuk lidhet me rrugë makine por rruga ekzistuese që lidh subjektet e tjera ndodhet në një distancë rreth 200m larg në vijë ajrore) dhe nga kjo rrugë ekzistuese për të futur në objekt kërkohej të hapet një rrugë rreth 600 m larg në të majtë të rrugës ekzistuese që

"H&M MINING" PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku "Vasil Shanto", Rruga, "Preng Bib Doda" Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

lidh komunën e Zall Herrit me ujmbledhësin e Bovillës sipas rrjedhjes pasi ne kete zone punojne firma qe shfrytezojne gurin gelqerore ,kurse rruget qe do te hapen do te jene vetem ne zonen qe kerkohet te shfrytezohet.



Fshati Herraj ne sfond lumi i Terkuzes

ORTOFOTO



"H&M MINING" PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku "Vasil Shanto", Rruga, "Preng Bib Doda" Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830


E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

Foto te realizuara nga Droni



Pamje zona nr. 799/3

FshatiHerraj



Pamje e mbuleses

"H&M MINING" PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku "Vasil Shanto", Rruga, "Preng Bib Doda" Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

ç. Skicat dhe planimetrite e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit

Objekte ne sherbim te aktivitetit do te jete kontenieri qe perdoret per shfrytezimin e objektit. Nga shoqeria dotevendoset vetem nje kontenier sanduiwch qe do sherbej si zyre per mbajtjen e dokumentave ne kantier. Perdorimi i ketyre objekteve te gatshme preferohet sepse jane te cmontueshme dhe mund te rivendosen ne vende te tjera. Jane cilesore dhe komforte si per stinen e dimrit edhe ne vere. Perparesite e perdorimit te paneleve sandwich

- 1- Lehtesisht te instalueshem dhe te cmontueshem, kane nje jetegjatesi 15-20 vjet
- 2- Kane lehtesi ne trasnport dhe zhvendosje
- 3- Mund te riperdoren disa here dhe nuk demtojne mjedisin
- 4- Te papershkueshme nga uji dhe zjarri , si dhe nga lageshtia
- 5- Durojne shpejtesi ere der ne 110 km/h
- 6- Jane te izoluara nga zhurmat
- 7- Sizmikiisht te qendrueshme der ne shkalle 7 richter


"H&M MINING" PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku "Vasil Shanto", Rruga, "Preng Bib Doda" Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com



- 1- Paneli i catise
- 2- Lesh xhami me flete metalike alumini
- 3- Elemente lidhes te galvanizuar
- 4- Pjate celiku per tavanin
- 5- Tra horizontal ne cati
- 6- Tra horizontal anesor
- 7- Tra persegjati
- 8- Dritare alumini
- 9- Tra horizontal fundor
- 10- Tra persegjati
- 11- Dera
- 12- Muri panel sandwich
- 13- Tra fundor persegjati
- 14- Dyshemeja
- 15- Pllake cimentoje
- 16- Tra horizontal fundor

“ H&M MINING” PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku “Vasil Shanto”, Rruga, “Preng Bib Doda” Pallati 1, Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

d. Përshkrim i procesit ndertimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/ perpunuese, sasitë e lendeve të para dhe produktet përfundimtare të projektit

Krahas me vrojtimit dhe hartografimet tona fushore në zonën e vendburimit, për të ndertuar prerjen e shkëmbinjve karbonatike, sikurse theksuam edhe më lartë, u diagnostikuan e përshkruan edhe një seri shlifesh (shlifet u moren në një largësi prej 20 m), mbështetur në të cilët prerja karbonatike e vendburimit paraqitet:

Në aspektin litologjik prerja e vendburimit ndërtohet kryesisht nga gelqeror, vende vende të dolomitizuar deri në 10 – 12 %, çka përfaqësojnë zëvendësime të gelqerorve nga dolomitet. Në pikpamje teksturore e strukturore gelqeroret janë shtrese trashë, kokërr imet, kompakte e të qëndrueshëm ndaj erozionit. Ndermjet gelqerorve takohen edhe lloje copezore - organogjene, ndonjëherë me permasa mbi 1 cm, çka e bëjnë sipërfaqen e gelqerorit të ashpër e më dalje e të futura. Llojet kokërr imet janë të bardha e më pamje sheqerore, ndërsa të tjerët janë ngjyrë gri – të bardhë, të bardhë – bezhe, ndonjëherë në sfondin gri – të bardhë ata marrin edhe nuanca të kuqërremta për shkak të perzjerjeve me pigmentet hekuri.

Gelqeroret e mesiperm me trashësi të dukshme në vendburim, prej rreth 350 m janë përcaktuar të kretakut të sipërm nepermjet faunes (rudiste, iriqe deti etj.) që është verëjtur në shlifet e shumta

Ndertimi gjeologjik i vendburimit.

Më termin vendburim këtu e poshtë do të nënkuptojmë shkëmbinjte karbonatike që përfshihen në sipërfaqen e kërkuar për shfrytëzim.

Vendburimi i gelqerorve në Zall Herr, bën pjesë në strukturën karbonatike të Makareshit, paralele e strukturës antiklinale karbonatike të Dajtit.

Studimit gjeologjik të strukturës së Makareshit i kanë kushtuar vëmendje të madhe shumë gjeologe, nisur nga mundësia për të gjetur naftë e gaz në strukturat e mbuluara paralele në perëndim të saj, ose lidhur me mundësinë e sigurimit të lendeve të para të ndertimit në teresi, dhe të lëndës së parë për prodhimin e çimentos në veçanti. Studime janë bërë edhe për kërkimin e boksitëve. Nder studimet e kryera, specifike janë prerjet stratigrafike veçanarisht në strukturat e Dajtit e të Makareshit të realizuara nga Peza L. (1,2,3), nepermjet të cilave (në lumin e Drojes dhe perroit të Zidollit), janë grumbulluar të dhëna të rëndësishme për stratigrafinë dhe litologjinë e formacionit karbonatik të kretakut të sipërm, dhe të paleogenit (paleocen, eocen), në strukturën e Makareshit.

Për të krijuar një ide për shkallën e detajuar të prerjeve stratigrafike në lumin e Drojes e të Zidollit, mjafton të përmendim që përveç vrojtimit dhe dokumentimit fushor, në vite janë marrë, studjuar e përcaktuar disa qindra kampione (shlife) qelqerori, dolomiti e llojet e

“H&M MINING” PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku “Vasil Shanto”, Rruga, “Preng Bib Doda” Pallati 1 Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

perziera te tyre. Nga ana tjetër theksojme se zona e vendburimit , ndodhet vetem 500 m larg ne juglindje te prerjes stratigrafike te detajuar e te njohur te Zidollit.

Ne kete menyre eshte me vend qe rezultatet e studimeve te meparshme te merren ne konsiderate, sepse ato paraqesin pune me vlere shkencore e praktike, ne deshifrimin e trashesise se shkembinjve karbonatike ne strukturen e Makareshit. E megjithë ate gjate rilevimit gjeologjik ne zonen e vendburimit, krahas me dokumentimet, pershkrimet makroskopike dhe hartografimet ne terren, nga ana jone u moren edhe 34 kampione (shlife) per diagnostikime dhe pershkrime te reja petrografike ne mikroskop, gjate perroit te Drojes dhe gjate rruges ne shpatin veriperendimor te perroit, ku gelqeroret shfaqen ne gjendje te fresket. Perpunimi dhe pergatitja e shlifeve u be ne Fakultetin Gjeologji – Miniera, ndersa diagnostikimi dhe pershkrimi petrografik i 34 shlifeve u be nga sedimentologu Prof. Dr. Polikron Theodhori.

Nga perpunimi i materialit fushor dhe diagnostikimeve e pershkrimeve petrografike te mesiperme, referuar edhe prerjeve te detajuara stratigrafike te kryera vite me pare me ne veri te vendburimit, rezulton se ne ndertimin gjeologjik te vendburimit marrin pjese vetem gelqeroret e kretakut te siperm.

Gelqeroret e kretakut te siperm (Cr₂). Sipas vrojtimeve te kryera nga ana jone, gjate perroit te Drojes i cili nderpret terthor strukturen karbonatike te Makareshit, gelqeroret e kratakut te siperm perhapen ne te gjithë vendburimin dhe jashte tij. Niveli me i poshtem i shfaqjes se tyre eshte shtrati i perroit te Drojes (nga 150 m – 157 m), ndersa kuota me e larte eshte 276 deri 359 m ne shpatin veriperendimor te perroit, dhe 285 m ne ekstremin juglindor te tij, ne afersi te kodres se Ljates. Pra territori i vendburimit perfshin luginen dhe dy shpatet e perroit te Drojes, brenda vijave kufizuese te zones se kerkuar per shfrytezim.

Sikurse shihet edhe nga profili gjeologjik i mesiperme, ndertuar mbi elementet e shtrueshmerise, te matur gjate rilevimit gjeologjik, gelqeroret e kretakut te siperm qe ndertojne vendburimin perbejne nje strukture monoklinale (me trashesi te dukshme rreth 350 m), me zgjatje veriperendim - juglindje me azimut 130⁰, renie verilindore me azimut 50⁰ – 70⁰, dhe kend renie nga 20 – 25 deri ne 40–45⁰. Nga studimet e kryera me pare ne rajon (1), rezulton qe gelqeroret qe ndertojne vendburimin (te quajtur edhe gelqerore me rudiste), qe perbejne pjesen e poshtme te struktures se Makareshit, i perkasin kretakut te siperm (santonian – kampanianit).

Ne aspektin litologjik shkembimi perfaqsohet nga gelqeror e me pak gelqeror i dolomitizuar, ose zevendesime te gelqerorit nga dolomiti, ç’ka nuk mund te vrojtohet drejt per drejt ne fushe, por nepermjet mikroskopit. Sikurse shihet edhe nga harta gjeologjike e rajonit te

“H&M MINING” PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku “Vasil Shanto”, Rruga, “Preng Bib Doda” Pallati 1 Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

vendburimit ne shkalle 1 : 25 000, formacioni karbonatik i vendburimit vazhdon edhe jashte kufijve te vendburimit, me ne lindje deri ne mbylljen e struktures se Makareshit.

Gelqeroret kane shtresezim stomor, here - here te qarte, jane te qendrueshem ndaj denudimit per pasoje japin relief te ngritur. Gelqeroret jane kokerrimet dhe pjeserisht te rikristalizuar, ndermjet tyre takohen lloje copzoro – organogjene, te cilat ndonjehere arrijne me permasa mbi 1 cm, duke e bere siperfaqen e gelqerorit shume te ashper, me plot kokrriza e cpoza te dala e te futura. Llojet kokerrimta jane me ngjyre te bardhe me pamje sheqerore, ndersa gelqeroret e tjere jane boje hiri – te bardhe dhe te bardhe – bezhe.

Ne disa raste ne sfondin bojhiri – te bardhe te gelqerorit verehen edhe konkrecione te kuqerremta, qe perfaqsohen nga kalciti me perzjerje argjile dhe te ngopura me pigmente hekuri. Shume çarje te gelqerorve jane mbushur me kalcit te mevonshem, i cili jo rralle arrin te formoje rromboedra te qarte e te medha.

Gelqeror shtresor me trashesi deri 1 m, kokerr imet, kompakt, me ngjyre te bardhe - hiri, ne siperfaqe vende vende te ndotur nga pigmente hekurore, me renie verilindore (Az. 60 -70⁰, kend renie 25 – 30⁰).

Ndertimi i prerjes se gelqeroreve qe do te shfrytezohen.

Krahas me vrojtimet dhe hartografimet tona fushore ne zonen e vendburimit, per te ndertuar prerjen e shkembinjve karbonatike, sikurse theksuam edhe me larte, u diagnostikuan e pershkruan edhe nje seri shlifesh (shlifet u moren ne nje largesi prej 20 m), mbeshtetur ne te cilet prerja karbonatike e vendburimit paraqitet:

Ne aspektin litologjik prerja e vendburimit ndertoet kryesisht nga gelqeror, vende vende te dolomitizuar deri ne 10 – 12 %, çka perfaqsojne zevendesime te gelqerorve nga dolomitet. Ne pikpamje teksturore e strukurore gelqeroret jane shtrese trashe, kokerr imet, kompakte e te qendrueshem ndaj erozionit. Ndermjet gelqerorve takohen edhe lloje copezore - organogjene, ndonjehere me permasa mbi 1 cm, çka e bejne siperfaqen e gelqerorit te ashper e me dalje e te futura. Llojet kokerr imet jane te bardha e me pamje sheqerore, ndersa te tjeret jane ngjyre gri – te bardhe, te bardhe – bezhe, ndonjehere ne sfondin gri – te bardhe ata marrin edhe nuanca te kuqerremta per shkak te perzjerjeve me pigmentet hekuri.

Gelqeroret e mesiperm me trashesi te dukshme ne vendburim, prej rreth 350 m jane percaktuar te kretakut te siperm nepermjet faunes (rudiste, iriqe deti etj.) qe eshte verejtur ne shlifet e shumte (1,6.).

“H&M MINING” PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku “Vasil Shanto”, Rruga, “Preng Bib Doda” Pallati 1 Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

Te dhena te shkurtra mbi llojin e mineralit.

Perberja kimike.

Materiali baze i klinkerit për çimento përmban **Ca, Si, Al dhe Fe**, te cilet mirren nga shkëmbinj të gëlqeror, gëlqeror merglor, mergele dhe argjila. Për këto elemente industria e çimentos ka këto kërkesa:

- Përmbajtja e **CaO** që është komponenti kryesor nuk duhet të jetë më i vogël se 42-43 %, ose rreth 76% përmbajtja e **CaCO₃** (Ciment standards of the world, 1980 Paris).
- Përmbajtja e **MgO** ne klinker, më e vogël se 4,5 %.
- Përmbajtja e **Na₂O + K₂O** më e vogël se 1.2-1.5 %
- **SO₄** më e vogël se 2 %,

Në vendin tonë fabrika e çimentos Fush Krujë dhe Elbasan kanë patur këto kondicione (S.Ohri, 1978):

- **CaO** mbi 43.5 %
- **MgO** 3.2 - 3.4 % (në klinker se bashku me argjilen, duhet të jetë nën 4.5%).
- **Na₂O + K₂O** nën 1 %
- **SO₄** nën 1 %

Ndërsa përmbajtja e **SiO₂, Al₂O₃, Fe₂O₃**, të marra së bashku (ne gëlqeror + argjile), duhet të sigurojë vlerat e kërkesave të koeficientit të ngopjes në klinker. Vlera e tyre varion : **SiO₂ 19-25%, Al₂O₃ 2-9%, Fe₂O₃ 1-5%**.

Kur në klinker përmbajtja e SiO₂ është e ulët, mund të shtohen rëra kuarcore, kuarcite etj.

Për Al₂O₃ shtesë, mund të përdoret boksiti, dhe për Fe₂O₃ shtesë ,përdoret mineral hekuri.

Jane të dëmshem : **silici i lirë** (në formën e kuarcit ose stralleve) mbi 80 μ, **klori** (për prodhimin e çimentos në rrugë të thatë mbi 0.015% është i dëmshëm), **elementet fosfatikë** mbi (P₂O₅) 1%.

Per te ditur perberjen kimike u moren 5 prova, sipas trashesise se te gelqerorit te vendburimit te studjuar, ne siperfaqe dhe ne shpimet e kryera, te cilat u derguan per perpunim e analizim,ne laboratorin e sherbimit gjeologjik shqiptar.

Vetite fiziko –mekanike te gelqerorit.

Gelqerori i vendburimit eshte pjese e struktures karbonatike te Makareshit me moshe kratak i siperme. Forma e shfaqjes se gelqerorve te vendburimit eshte shtresore (shih fotot me siper), me teksture masive, te prekur nga proceset dytesore si kalcizimi dhe dolomitizimi.

“H&M MINING” PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku “Vasil Shanto”, Rruga, “Preng Bib Doda” Pallati 1 Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

Vetite fiziko mekanike kane te bejne me fortesine dhe qendrueshmerine e gelqerorit te vendburimit dhe e mbetjeve te tij, ne perdorime te tjera si lende e pare ndertimi ne gjendje natyrore,ose e perpunuar per llaçe e betone te ndryshme. Pesha vëllimore e percaktuar nga analiza vlen per shkembim primar te pashkriferuar, ne rastin kur gelqerori do te dale nga kariera pra do te copetohet, do te aplikohet koeficienti i shkrfetimit. Nga analiza e kampioneve parametrat fiziko – mekanike te gelqerorit te vendburimit jane :

Rezistenca ne gjendje natyrale	- 800 - 1100 kg /cm ²
Rezistenca ne gjendje te lagur	- 800 deri 1000 kg /cm ²
Rezistenca ne gjendje te ngrire	- 800 - 900 kg /cm ²
Pesha volumore	- 2.61 g /cm ³
Pesha specifike	- 2.79 g /cm ³

Kushtet hidrogeologjike te vendburimit.

Duke gene se vendburimi ndertohet teresisht nga shkembinj karbonatike te kretakut te siperm, edhe ujrata nentoksore i perkasin ketyre shkembinjve.Gelqeroret e kretakut te siperm qe shfaqen ne siperfaqe, ndertojne strukturen monoklinale te Makareshit me zgjatje veriperendim – juglindje, dhe renie verilindore.

Gelqeroret e vendburimit jane shtresore dhe me çarje, perveç planeve te shtresezimit. Per nga ujembajtja e tyre gelqeroret ne teresi karakterizohen nga nje filtrim i dobishem i larte i reshjeve atmosferike, dhe pershkueshmeri te larte, natyrisht ne vartesi te shkalles se çarshmerise, te shtresezimit, karstezimit dhe nderlikimit tektonik te tyre. Ndersa gelqeroret e vendburimit karakterizohen nga ujembajtje e paket, çka spjegohet me drenimin e larte te ujrave ne thellesi, kryesisht nepermjet shtresezimit te dukshem dhe çarshmerise se gelqerorve.

Ujrat e drenuar dhe ato siperfaqore shkarkohen ne Lumin, i cili eshte edhe niveli me i poshtem i shfrytezimit te gelqerorve te vendburimit. Nga sa thame me larte kushtet hidrogeologjike te vendburimit jane te favorshme, sepse edhe gjate hapjes se shkallve te shfrytezimit, ujrata nepermjet shtresezimit do te drenojne ne thellesi, drejt perroit te Drojes (ujembledhesi).

Kushtet tekniko-minerare.

Forma e terrenit te vendburimit ne trajten e nje lugine e lumit te terkuzesne forme V – je, i ngjan konfiguracionit te nje kariere te shfrytezuar me pare e me pas te rikuperuar. Prandaj ne aspektin e projektimit e te shfrytezimit, forma relievit te sotem eshte nje kusht mjaft i

“H&M MINING” PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku “Vasil Shanto”, Rruga, “Preng Bib Doda” Pallati 1 Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

favorshem per projektimin e shfrytezimin e vendburimit me kariere. Relievi me ngritje graduale ne te dy shpatet e vendburimit favorizon hapjen e rrugeve per te hyre ne shkallet e karieres me mjetet e zbulimit, te shpimit, te ngarkimit, dhe te transportit te materialit te prodhuar.

Renia per ne verilindje, pergjithesisht e bute, dhe kryq drejtimit te shkallve te karieres nuk e favorizon rreshqitjen apo rrezimin e gelqerorve ne shkallet e karieres gjate shfrytezimit. Mbulesa e gelqerorve ne siperfaqen e vendburimit eshte e vogel, dhe nuk perben ndonje rrezik gjate zbulimit te gelqerorit per shfrytezim.

Tektonika.

Vendburimi i gelqerorve perfaqson pjesen e poshteme te struktures monoklinale karbonatike te Makareshit. Ka shtrirje veriperendim – juglindje 330° , dhe renie verilindore $50 - 70^{\circ}$. Gelqeroret jane shtrese trashe dhe ne pergjithesi ruajne drejtimin e renies per ne verilindje, por sipas matjeve qe kemi bere gjate rilevimit gjeologjik, ne pika te ndryshme kendi i renies se tyre luhatet nga $15 - 20 - 30^{\circ}$. Kjo tregon qe vete struktura monoklinale e Makareshit ne sektorin e vendburimit eshte e trazuar nga shkeputje tektonike te cilat kane levizur gelqeroret nga poshte larte, kryesisht sipas planit te shtresezimit te tyre, duke bere qe edhe kendi i renies se tyre te jete i ndryshem. Nga ana tjeter ne harten gjeologjike 1 : 200 000 jane evidentuar edhe disa shkeputje terthore, por qe nuk arrijne deri ne vendburim. Keshtu, efekti tektonikes shkeputse gjate shfrytezimit te vendburimit, do te jete i pa rendesishem.

Punimet e kryera, metoda e llogaritjes se rezervave.

. **Rilevimi gjeologjik.** Nepermjet rilevimit gjeologjik u plotesua dhe sakesua me tej harta gjeologjike ne shkalle 1 : 25 000 e rajonit te vendburimit, dhe prerja e struktures karbonatike te Makareshit. Per kete qellim u bene vrojtime ne shpatin veriperendimor te tij gjate rruges auto, si dhe vrojtime ne shpatin juglindor, per te sakesuar kufirin jugperendimor te struktures karbonatike te Makareshit. Gjate vrojtimit ne itineraret e mesiperem u moren nje sere xhveshjesh gjeologjike te cilat u pershkruan dhe hartografuan ne harten gjeologjike ne shkalle 1 : 25 000, me prerjen perkatese.

Si rezultat i vrojtimit, punimeve dhe percaktimit te kryera u ndertua harata gjeologjike e vendburimit me prerjet perkatese, nepermjet te cilave u be edhe llogaritja e rezervave gjeologjike te gelqerorit, i cili kerkohej per shfrytezim per prodhimin e cimentos.

Germime siperfaqesore. Krahas me xhveshjet gjeologjike natyrale te shkembinjve karbonatike ne zonen e vendburimit, per qellime dokumentimi e marrje kampionate u

U maten siperfaqet dhe u nxor mesatare e dy siperfaqeve te shkalleve njera mbi tjetren dhe u shumezuan me lartesine e shkalles 10 m dhe ne tabelen me poshte jepet te dhenat e matjeve te siperfaqeve te nxjerra ne kompuiter.

Prodhimi i parashikuar ne projektin e shfrytezimit eshte i mbeshtetur ne rezervat e llogaritura ne çdo shkalle si me poshte

Nr.	Shkallet	Siperfaqetne shkalle	Siperfaqe mesatare	Volumi m3
1	610	7900	(mbi S ₆₁₀ +0)/2	26333
2	600	18600		132500
3	590	23555		210775
4	580	21650		226025
5	570	19700		206750
Shuma rezerva gure gelqeror				802383

Volumet e llogaritura ne tabelen me sipër janë ne masiv.

Rezervat e nxjerrshme janë 802 383 m³

Per te verifikuar saktesimin e rezervave te llogaritura me metoden e mesiperme, nga kompiuteri u maten siperfaqet e shkalleve ne vizatimin karriera ne ne gjendjen perfundimtare dhe nga kahsimi i dy metodave te llogaritjes se rezervave rezulton se ndryshimi ne sasi i rezervave eshte 0.08 ose rreth 8 %

Nga kjo mund te pranojme sejcilen prej sasive te rezervave te llogaritura . Meqenese me poshte do te operojme me rezervat sipas shkalleve, do te pranojme si rezerva ato te llogaritura me matjen me kompiuter te shkalleve

Me te njejten metode u llogarit edhe sasia e mbuleses sterile e cila nga tereni rezulton se mbulesa varion nga 0.09-0.1 m. Te dhenat jane paraqitur ne tabelen me poshte:

Shenim:

Llogaritja e mbuleses, per sejcilen shkalle eshte bere duke zbritur siperfaqet e shkalleve te njepasnjeshme dhe diferenca shumzohet me trashesine e mbuleses

"H&M MINING" PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku "Vasil Shanto", Rruga, "Preng Bib Doda" Pallati 1 Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

Pjesa minerare

Te dhena te pergjithshme te objektit

Objekti i gelqeroreve ndodhet ne, Komuna Zall Herr Tirane

Relievi i zones eshte kodrinordhe i çveshur nga pyje dhe binesi.

Kuota me e ulet eshte +520m ne jug , ku kodra bie drejt terrenit fushor dhe +580 ne veridrejte kodrave qe rrethojne objektin ku kodra vjen e ngrihet mbi nivelin e detit.

Konturi i objektit eshte shenuar ne harten 1:25.000 dhe kufizohet nga pikat me koordinatat e meposhtme:

Koordinatat e zonës nr. 799/3, Zall Herr

Pika	X	Y
1	4590550	4402900
2	4590729	4403323
3	4590665	4403441
4	4590590	4403495
5	4590372	4403265
6	4590332	4402970

Sipërfaqja e zoës në planin horizontal është 0.141 km²

Siperfaqja e zones se kerkuar per shfrytezim eshte pergjithesisht e zhveshur nga bimesia dhe shfrytezimi nuk shkakton demtime ne mjedis, apo probleme sociale.

Ne siperfaqen e rilevuar ne shkallen 1: 1000 jane trasuar dy profile dhe pikerisht profili 1-1, 2-2, 3-3, Gelqeroret kane dalje ne siperfaqe duke qene te mbuluar edhe me pak toke vegjetale ku trashesia nuk i kalon 10 cm. ne pjese te vecanta

Gelqeroret jane ne trajte shtresash duke filluar nga 20 cm e deri ne 1m te cilet jane te lidhura dhe vende-vende kalojne ne blloqe.

“H&M MINING” PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku “Vasil Shanto”, Rruga, “Preng Bib Doda” Pallati 1 Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

Ne hartimin e pjeses minerare te ketij studimi, percaktimin e menyres se shfrytezimit radhen e shfrytezimit dhe elemente te tjere, jane mare ne konsiderate :

- Topografia e objektit ne zonen e shfrytezimit dhe per rreth saj ;
- Sasia e rezervave te nxjerrshme ne kuota ta ndryshme te vendburimit Sasia e mbuleses dhe e sterialeve qe duhet te zhvendosen jashte zones se shfrytezimit;
- Koeficienti mesatar i zbulimit ;
- Mundesite e lidhjes se vendburimit me rrugen rurale
- Karakteristikat fiziko-mekanike dhe gjeomekanike te formacioneve qe ndertojne vendburimin;
- Sistemi i çarjeve, orientimi i tyre dhe materiali mbushes qe ndodhet ne to;
- Tregues te rendesishem gjeomeknke dhe gjeoteknike si RQD dhe RMR;
- Infrastruktura ekzistuese dhe permiresimet e saj ;
- Eksperience e shfrytezimit ne zonen perreth

Zgjedhja e menyres se shfrytezimit.

Pas llogaritjeve paraprake te ndara perkatesisht ne shkalle dhe treguesit e tjere, rezervat te gjeologjike jane dhene ne tabelen e me poshteme

Nr.	Shkallet	Siperfaqetne shkalle	Siperfaqe mesatare	Volumi m3
1	610	7900	$(m_{bi} S_{610+0})/2$	26333
2	600	18600		132500
3	590	23555		210775
4	580	21650		226025
5	570	19700		206750
Shuma rezerva gure gelqeror				802383

Rezervat e nxjerrshme jane 802 383 m3

Nga kjo mund te pranojme sejcilen prej sasive te rezervave te llogaritura . Meqenese me poshte do te operojme me rezervat sipas shkalleve, do te pranojme si rezerva ato te llogaritura me matjen me kompiuter te shkalleve

Me te njejten metode u llogarit edhe sasia e mbuleses sterile e cila nga tereni rezulton se mbulesa varion nga 0.09-0.1 m. Te dhenat jane paraqitur ne tabelen me poshte:

“ H&M MINING” PROJEKTE E KONSULENCE

NUIS: L62412026R

Blloku “Vasil Shanto”, Rruga, “Preng Bib Doda” Pallati 1 Tiranë

Tel. 00355672051830

E mail: dhuro_caushi@yahoo.com

Llogaritja e mbuleses

Nr.	Shkallet	Siperfaqet ne shkalle	Siperfaqe mesatare	Volumi m3
1	610	10675	(mbi S ₆₁ +0)/2	718
2	600	17620	14147.5	1414
3	590	22890	20255	2025
4	580	27310	25100	2510
5	570	29440	28375	2837
Shuma mbuleses				18291

Nga tabelat e llogaritjes se rezervave gjeologjike dhe volumit te mbuleses koeficienti i zbulimit te objektit zerulton :

$$Kz = 18291 \text{ m}^3 / 878775 = 0.010 \text{ m}^3/\text{ton}$$

Duke mare ne konsiderate elemente te tjere si: topografine, sasine e rezervave , karakteristikat gjeomekanike te shkembenjve, elementet e shtruarjes dhe koeficientin e zbulimit, eshte parashikuar shfrytezimi me karriere i rezervave te llogaritura te objektit dhe me poshte jane paraqitur llogaritjet perkatese lidhur me prodhimin dhe efektivitetin ekonomik ne shfrytezimin e gjeperorve te objektit.

Kapaciteti nxjerrjes i minieres, regjimi i punes, nderesa ne dite, dite ne muaj, ose vit, Grafiku i punimeve te zbulimit dhe grafiku i podhimit per gjithe minieren.

Kapaciteti Prodhues

Ne konkurimin e bere ne METE per zonen e kerkuar, subjekti i eshte kerkuar qe ne projektin e shfrytezimit , ne projektin e veprimtarise minerare duhet te realizoje prodhimin prej 25000 m3/vit, Prodhimi i gelqeroreve nga shfrytezimi i ketij vendburimi ne zonen e kerkuar do te kete si destinacion perdorimin e tij ne industrine e ndertimit ne forme te gureve te prodhuar direkt nga karriera dhe te materialit te perpunuar si rere, granil apo çakell

Subjekti disponon impiant thyerje dhe fraksionimi ne nje objekt dhe do te transferohet ne objekt

Regjimi i punes

Per realizimin e prodhimit te parshikuar karriera do te punoje gjate gjithë vitit 300 dite ne vit, 25-26 dite ne muaj me nje nderese ne dite

Per vitin e pare te aktivitetit te saj karriera do te punoje me nje intensitet me te larte per realizimin e zbulimit, hapjes e rruges ne pjesen e poshteme, sistemimet e ndryshme dhe te prodhimit.

Grafiku i zbulimit dhe prodhimit

Sasia e pergjitheshme e zbulimit te kesaj karriere eshte 8280 m³ dhe parashikohet te realizohet pjeserisht ne vitin e pare dhe pjeserisht paralelist me shfrytezimin

Vellimi i pergjithshem i zbulimit ne vitet e pare duke bere zbulim ne shkallet +340m dhe +310m, nga njeri ekstrem deri ne tjetrin te zones se shfrytezimit do te jete 8280 m³

Ne tabelat e meposhteme jepet parashikimi i prodhimit ne vite ne shkalle

